

# Takim pune i ekipit menaxhues të projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”

## Procesverbali i mbledhjes

Ref. 5/2011

**Vendi:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

**Data:** 14 Dhjetor 2011

**Koha:** 11:00 – 12:40

### **Pjesëmarrësit:**

**Gjylfidane Kadrijaj**, Drejtore e Departamentit të Sistemit të Pagesave, BQK

**Dukagjin Shylemaja**, Zëvendës Drejtor, TEB

**Akile Cërnobregu**, Udhëheqëse e Departamentit të Pagesave, PCB

**Florin Lila**, Zëvendës Drejtor, PCB

**Boryana Ivanova Mustafa**, Drejtore e Pagesave dhe Thesarit, NLB

**Edmond Jashari**, TEB

**Ozenc Alkan Asik**, TEB

**Ardita Zogjani**, RBKO

**Kreshnik Kosumi**, Zyrtar për administratë dhe financa, SHBK

**Edmond Murati**, MPMS

**Makfire Osmani**, KUR Prishtina

**Milot Kelmendi**, Menaxher i Performancës dhe Analizës, KEK

**Arzen Çavdarbasha**, Koordinator i Zhvillimeve DSNP, BQK

**Masar Baxhaku**, Zyrtar i Mbikëqyrjes DSNP, BQK

Munguan:

**Robert Wright**, Shef Kryesor Ekzekutiv, RBKO (*kryesues*)(*me njoftim paraprak*);

**Diturie Hoxha**, Drejtore Ekzekutive, SHBK (e zëvendësuar)

**Përfaqësuesit e MF/Thesari, ATK dhe PTK** (munguan pa njoftim paraprak) **dhe OEK** (me njoftim)

Takimi filloi në ora 11:00.

Znj. Gjylfidane Kadrijaj hapi takimin, përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje, njëkohësisht shprehu pakënaqësinë për mospjesëmarrje nga disa anëtar të grupit.

### **Diskutimet dhe prezantimet**

- **Miratimi i procesit dhe konkluzioneve të takimit të fundit**

U konfirmua plotësimi i pikave të konkluzioneve dhe nga anëtarët u miratua njëzëri procesverbali i takimit paraprak të mbajtur më 21 shtator 2011.

- **Informim/Prezantim nga ana e grupit punues në kuadër të ekipit për menaxhim të projektit për zvogëlim të pagesave në para të gatshme**

Nën grupi punues bëri prezantimin e punës së tyre që nga takimi i fundit deri tani. Sqaruan për takimet që ka bërë grupi me kompanitë e teknologjisë informative si dhe propozimet të cilat i kanë pranuar nga ana e këtyre kompanive. Gjithashtu njoftuan edhe për konkluzionet që kanë nga takimet me këto kompani: të standardizohen të gjitha faturat e kompanive publike për të gjitha urdhër pagesat në Kosovë gjatë tri fazave të ardhshme. Pastaj njoftuan edhe për takimet që kanë pasur me kompanitë utilitare, dhe gatishmërinë e këtyre kompanive për ta pranuar këtë proces, por me qëllim që kjo të mos shkaktojë shpenzime të papërbalueshme për këto kompani për shkak të kufizimeve financiare.

Në emër të BQK-së Znj. Gjylfidane Kadrijaj shprehu gatishmërinë që BQK-ja të përkrah këto iniciativa të cilat kanë qëllim zvogëlimin e pagesave në para të gatshme në Kosovë, përmes krijimit të legjislacionit përkatës apo nevojave tjera. Gjithashtu Znj. Gjylfidane Kadrijaj vlerësoi lartë punën që ka bërë nën-grupi ku brenda pak kohësh ka dal me iniciativa konkrete.

Z. Dukagjin Shylemaja shprehu pakënaqësinë e tij lidhur me pamundësinë e pajisjes me kartela për përfituesit e pensioneve të Kosovës për shkak të marrëveshjes me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale e cila ndalon lëshimin e kartelave për këtë kategori të klientëve. Lidhur me këtë çështje edhe Z. Florin Lila shprehu shqetësimin e tij pasi që sipas tij kjo marrëveshje po i shkakton shumë shpenzime bankës së tij që 3-4 vite dhe nëse nuk do të ketë ndryshim të marrëveshjes me Ministrinë përkatëse, mund të ndryshojë mendim ndaj kësaj marrëveshje.

Në anën tjetër, përfaqësuesi nga MPMS, Z. Edmond Murati, njoftoi për ndryshimet që kanë bërë në sistem MPMS e cila tani do të jetë më fleksibile sa i përket problemeve me pensione, dhe shumë shpejt do të lejohet që të lëshohen kartela edhe për mbajtësit e llogarive të pensioneve.

- **Informim/Prezantim lidhur me VISA dhe MASTERCARD**

Në mungesë të Z. Wright i cili do të prezantonte lidhur me VISA dhe MASTERCARD, u vendos që materiali nga këto prezantime tu dërgohet të pranishmëve në mënyrë që të analizojnë përmbajtjen e tij, dhe në ndërkohë të paraqesin pyetjet dhe sugjerimet e tyre në takimin ku do të jenë të pranishëm edhe përfaqësues nga këto kompani.

- **Instrumentet e pagesave dhe терминаlet - Kosova në krahasim me shtetet në Evropën Qendrore dhe Juglindore (*prezantim i shkurt*)**

Znj. Gjylfidane Kadrijaj në mënyrë të shkurtër prezantoi të dhënat për instrumentet e pagesave për vendet në rajon, si dhe krahasimin e këtyre të dhënave. U vlerësua rritja e numrit të instrumenteve të pagesave, por mbetet akoma shumë punë pasi që Kosova është ende mbrapa në krahasim me vendet në rajon.

## **Konkluzionet e Takimit dhe Hapat e ardhshëm**

- Vazhdimi i punës së ekipit menaxhues të projektit për reduktim të pagesave në para të gatshme përmes nën-grupit punues me qëllim të finalizimit të standardizimit të faturës (që ende është draft), dhe punëve në krijimin e web-platformës, kontaktet individuale me së paku disa nga kompanitë, etj
- Pjesëmarrësit të analizojnë materialin e pranuar nga MasterCard (të përgatitur enkas për BQK) dhe Visa, dhe të kthejnë opinionin e tyre në *paymentsystems@bqk-kos.org*;
- Të ftohet Visa dhe MasterCard për prezantim në BQK sipas kërkesës së ekipit menaxhues të projektit për zvogëlim të pagesave në para të gatshme **(përfshirë mundësinë e asistencës financiare)**;
- Bankat të komunikojnë me MPMS lidhur me shqetësimet e shprehura në takim rreth pensioneve, do të ndërmjetësoj edhe BQK-ja;
- Nën-grupi të komunikojë me kompanitë individualisht (kërkesë e përfaqësuesit të KEK-ut) lidhur me çështjet tekniko-operacionale rreth fillimit të implementimit të **web-servisit** ;
- Ka hapësirë dhe mundësi për rritjen e përdorimit të pagesave pa para të gatshme (kartela, e-banking, etj) në Kosovë.
- Nga ekipa në fjalë të shtohet aktiviteti në promovim të instrumenteve elektronike të pagesave dhe reduktim të keshit. Të përkrahet nisma për krijim të një qendre për procesim kombëtar të kartelave (shtylla III e SZHSP) dhe krijimi i mundësive të përdorimit të kartelave (në POS, etj) më sa më me pak shpenzime.